

VENDIM
Nr. 457, datë 26.7.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS ‘BELUL BERISHA’”, NË BASHKINË ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim-asfaltim i rrugës ‘Belul Berisha’”, në Bashkinë Elbasan.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “ndërtesë”, me sipërfaqe 17 m², dhe “truall”, me sipërfaqe 50 m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 1 333 126 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e gjashtë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 333 126 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Elbasan.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Elbasan.
 8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Elbasan, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Elbasan.
 10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË CILAT PREKEN NGA OBJEKTI: “SISTEMIM ASFALTIM I RRUGËS ‘BELUL BERISHA’”, ELBASAN

			Vërtetim pronësie				Truall				Banesa			Shpronësi-mi		
Nr.	Familja që shpronësoh et	Nr. i pasur.	m ² truall banesë njësi			Shpron. m ²	Çmimi shpron. lekë/m ² lekë		Sip. banës. m ² preket shpro.		Çmimi lekë/m ²	Shpron. lekë	Shuma lekë	Vërejtje		
1	Malvin Sefer Shuka	22/179	118,00	45.90	0,00	38.00	12764	485032.00	17.00	0.00	40878	694926.00	1179958.00	Konfir. ZVRPP		
2	Zylyftar Shefqet Mujo	22/140	299,70	133.6 0	0,00	12.00	12764	153168.00	0.00	0.00	40878	0.00	153168.00	Konfir. ZVRPP		
					0,00	50.00		638200.00				694926.00	1333126.00			